

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SONDATA” SHPK

Në Tiranë, sot, më datë 09/09/2025, ortaku i vetëm i shoqërisë:

1. **Etiev Mane**, shtetas shqiptar, lindur më 10.05.1985 në Vajzë, Vlorë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, identifikuar me leter njoftimin ID me nr. 036493314 dhe nr personal I50510119C, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

Vendosi të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

Neni 1
DATA E THEMELIMIT

Sot, më datë 09/09/2025, themeluesi Etiev Mane vendosi të krijojnë një shoqëri me emërtimin **“SONDATA” SHPK**

Neni 2
FORMA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

Neni 3
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është **“SONDATA” SHPK**

Neni 4
SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Dibrës, Kompleksi Arlis, Shk. 4, Nr. 7/6, Zona Kadastrale 8120, Tiranë, Albania.

Me miratim të organeve të saj, Shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

Neni 5
KOHËZGJATJA



Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar. Shoqëria fiton personalitetin juridic në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "SONDATA" SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Ofrimi i shërbimeve të konsulencës dhe organizimit të biznesit, konsulencës për implementimin e sistemeve informative dhe konsulenca teknologjike në sektorin informatik. Tregtimi i produkteve hardware e software. Operimi në sektorin e telekomunikacionit, telemarketing call center inbound dhe outbound duke kryer çdo lloj veprimtarie nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të tretëve me seli në Shqipëri apo në çdo vend tjetër që ka lidhje me Republikën e Shqipërisë, duke respektuar ligjin në fuqi. Tregtimi i shërbimeve të lidhur me publikimin dhe publicitetin në web. Të gjithë aktivitetet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe financiare të lidhura me objektin e shoqërisë. Shoqëria mund të ketë pjesëmarrje në formën e mbajtjes së aksioneve/kuotave apo interesave të tjera në shoqëri tregtare apo ndërmarrje me objekt veprimtarie që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 500 000 (pesëqind mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Etiev Mane i cili zotëron 1 (një) kuotë me me vlerë nominale 500 000 (pesëqind mijë) Lekë duke i dhënë të drejtën e pjesëmarrjes 100% të kapitalit aksionar.

Kapitali është i ndarë në 1 (një) kuotë i zotëruar nga ortaku i vetëm.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një nga Bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë.


Neni 8

ADMINISTRATORI

Administratori i shoqërisë "SONDATA" SHPK do të jetë:

Z. Etiev Mane, shtetas shqiptar, lindur më 10.05.1985 në Vajzë, Vlorë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, identifikuar me leter njoftimin ID me nr. 036493314 dhe nr personal I50510119C, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.



Neni 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore. Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapo krijuar gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkëngjitur.

Autorizohet Administrator, Z. Etiev Mane ose çdo përfaqësues i posaçëm i caktuar prej tij për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESI I SHOQËRISË
"SONDATA" SHPK

Z. ETIEV MANE

Etiev Mane 